



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 11 paragrafi 3 dhe 17 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Kërkesën për tërheqje të Aplikacioneve për ndërtimin e dy (2) njësive gjeneruese të energjisë elektrike në Lumin Lepenc (HC Lepenc I. 1.900 kW, ZK Vërbeshticë, Jazhincës dhe Shtërpcës, Komuna e Shtërpcës dhe HC Lepeni II. 3.500 kW, ZK Sllatin/fshati Gërlicë Komuna e Kaçanikut, të datës 01.08.2012 të ndërmarrjes “Devolli Group” sh.p.k., me adresë rruga “Zahir Pajaziti” p.n. Pejë, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 12 tetor 2012 nxori këtë:

VENDIM

- I. REFUZOHET dhënia e autorizimit preliminar për ndërmarrjen “Devolli Group” sh.p.k. për ndërtimin e dy (2) njësive gjeneruese të energjisë elektrike në Lumin Lepenc (HC Lepenc I. 1.900 kW, ZK Vërbeshticë, Jazhincës dhe Shtërpcës, Komuna e Shtërpcës dhe HC Lepeni II. 3.500 kW, ZK Sllatin/fshati Gërlicë Komuna e Kaçanikut, me adresë rruga “Zahir Pajaziti” p.n. Pejë, Republika e Kosovës.**

Arsyetim

- ZRRE me datë 07.04.2011 nga ndërmarrja “DEVOLLI GROUP”sh.p.k., ka pranuar aplikacionet për marrjen e autorizimit për ndërtimin e dy (2) njësive gjeneruese të energjisë elektrike në Lumin Lepenc (HC Lepenc I. 1.900 kW, ZK Vërbeshticë, Jazhincës dhe Shtërpcës, Komuna e Shtërpcës dhe HC Lepeni II. 3.500 kW, ZK Sllatin/fshati Gërlicë Komuna e Kaçanikut.
- ZRRE me datë 08 prill 2011 ka njoftuar aplikuesin se aplikacionet janë pjesë e pakës tenderuese të shpallur nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave e Republikës së Kosovës e datës 31 mars 2010.
- ZRRE me datë 28 qershor 2011 ka njoftuar aplikuesin se ju ka drejtuar organeve relevante dhe ka kërkuar prej tyre të sqarohet gjendja se iniciimi i procedurës së tenderimit i bërë nga Qeveria ishte dhe mbetet në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
- ZRRE me datë 07 maj 2012 ka pranuar njoftimin mbi anulimin e tenderit për Hidrocentralet e Vogla që ishin pjesë e pakës tenderuese të Shpallur nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës.



- ZRRE me datë 08 maj 2012 ka njoftuar aplikuesin se pas pranimit të njoftimit mbi anulimin e tenderit do të filloj me vlerësimin e aplikacioneve sipas Rregullës për Procedurën e Autorizimit dhe legjislacionin në fuqi.
 - ZRRE me datë 01 qershor 2012 ka lëshuar shkresën lidhur me vlerësimin fillestar të aplikacioneve, ku ka kërkuar nga ndërmarrja “Devolli Group” sh.p.k. të sjellë dëshmitë sipas shtojcës III të aplikacionit të cilat janë të rëndësishme për këtë fazë të vlerësimit si dhe ka kërkuar që dëshmitë të sillen brenda afati ligjor të përcaktuar me nenin 11 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit.
 - ZRRE me datë 31 korrik 2012 ju ka njoftuar se nëse aplikuesi vonon pa arsye bindëse përgjigjet e kërkuara, ka të drejtë ta refuzojë aplikacionin, ose të vendos bazuar e dokumentet dhe informacionet ekzistuese dhe të njoftoj aplikuesin për vendimin e saj.
 - ZRRE me datë 01 gusht 2012 nga përfaqësuesi i ndërmarrjes “Devolli Group” sh.p.k. ka pranuar kërkesën për tërheqje të aplikacioneve të protokolluar me nr. 329/11 dhe nr. 330/11 të datës 07 prill 2011.
 - ZRRE pas analizimit të kërkesës për tërheqje të aplikacioneve dhe vlerësimit të aplikacioneve, si dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar